REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01 - 637
Data/Datum/Date: 08 / 05 / 2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -4-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr.89/2026
Datë:08/05/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 10 (paragrafi 7) të Rregullores nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, si dhe në përputhje me rekomandimin e Njësisë Përgjegjëse për Mbikëqyrjen e Performancës, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë në detyrë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Deklarata e Performancës së Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2025.
2. Deklarata e Performancës publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Njësia përgjegjëse obligohet të dërgojë një kopje të Deklaratës së Performancës në Sekretariatin Koordinues të Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Donika GËRVALLA SCHWARZ

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

Vendimi u dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Anëtarëve të Njësisë përgjegjëse për Mbikëqyrje të Performancës së Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*

DEKLARATA E PERFORMANCËS

Data:	08.05.226
AGJENCIA	INSPEKTORATI I MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	MINISTRIA E DREJTËSISË
Miratimi i Raportit të Performancës (Po/Jo)	Nga të dhënat e raportuara, rezulton se shumica e objektivave dhe rezultateve të planifikuara për vitin 2025 janë realizuar me sukses. Për secilin indikator është shënuar nëse realizimi është bërë apo jo, dhe shumica e tyre figurojnë të përmbushura. Bazuar në këtë, mund të konsiderohet se **Raporti i Performancës, Po, është miratuar.**

Vlerësimi përshkrues i performancës

Raporti analizon objektivat strategjike të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, të cilat janë formuluar sipas parimit SMART (Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, Relevante dhe i Përcaktuar në Kohë). Vlen të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e objektivave është realizuar plotësisht, ndërsa një objektiv nuk është realizuar. Për më tepër, raporti evidenton harmonizimin e këtyre objektivave me prioritet strategjik të Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë, duke garantuar një përputhje institucionale dhe një kontribut të drejtpërdrejtë në përmbushjen e mandatit të Agjencisë.

Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të Planit të Performancës për vitin 2025, ka paraparë pesë (5) objektiva, si në vijim:

1. Siguria dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në institucionet korrektuese;
2. Inspektimi i kushteve të përgjithshme në institucionet korrektuese, në përputhje me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), si dhe rehabilitimit dhe riintegrimit të personave të dënuar;
3. Zbatimi i procedurave ligjore për të dënuarit e liruar me kusht nga SHSK-ja dhe zbatimi i procedurave ligjore për mbikëqyrjen e dënimeve alternative;
4. Ngritja e kapaciteteve të Inspektoratit;

5. Vlerësimi vjetor i institucioneve korrektuese dhe Drejtorive rajonale sprovuese.

Bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të zbatimit të Planit të Performancës për vitin 2025, Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë ka arritur të realizojë rreth 80% të aktiviteteve dhe objektivave të planifikuara.

Realizimi i këtyre objektivave reflekton angazhimin e vazhdueshëm të Inspektoratit për të forcuar mekanizmat e mbikëqyrjes dhe për të kontribuar në garantimin e një sistemi të drejtë, funksional dhe të sigurt të ekzekutimit të sanksioneve penale në Republikën e Kosovës. Aktivitetet e ndërmarra janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit dhe cilësisë së shërbimeve korrektuese dhe sprovuese.

Fushat me performancë të mirë

Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e agjencisë ekzekutive përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe inspektimin e institucioneve korrektuese dhe sprovuese, gjatë vitit 2025 ka shënuar rezultate pozitive në realizimin e një pjese të konsiderueshme të objektivave të planifikuara. Aktivitetet e ndërmarra gjatë periudhës raportuese kanë kontribuar në forcimin e rolit mbikëqyrës të Inspektoratit dhe në përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore dhe procedurale në institucionet përkatëse.

Në këtë drejtim, janë realizuar një sërë aktivitetesh që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e inspektimeve në institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe në Drejtoritë rajonale të Shërbimit Sprovues të Kosovës. Ndër aktivitetet kryesore përfshihen hartimi i planit vjetor të punës së Inspektoratit, realizimi i inspektimeve të rregullta dhe jo të rregullta në terren, si dhe përpilimi i raporteve të inspektimeve me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

Këto aktivitete kanë ndikuar në forcimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, në vlerësimin e kushteve të përgjithshme në institucionet korrektuese, si dhe në monitorimin e procedurave që lidhen me ekzekutimin e dënimeve alternative dhe mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht në Drejtoritë rajonale sprovuese. Po ashtu, është realizuar vlerësimi vjetor i institucioneve përkatëse, duke kontribuar në rritjen e nivelit të llogaridhënies institucionale dhe në identifikimin e fushave për përmirësim.

Bazuar në aktivitetet e realizuara dhe rezultatet e arritura gjatë vitit raportues, performanca në këto fusha vlerësohet si e realizuar në një nivel të kënaqshëm, duke reflektuar angazhimin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë në përmbushjen e mandatit të tij dhe në forcimin e mbikëqyrjes institucionale në sistemin korrektues dhe sprovues në Republikën e Kosovës.

Prioritetet për përmirësimin e performancës

Raporti evidenton katër objektiva të realizuara dhe një objektiv, i cili nuk është realizuar. Objektivi i katërt i paraqitur në Planin e Perfomancës për vitin 2025 "Ngritja e kapaciteteve të Inspektoratit", ka mbetur i parealizuar. Ky objektiv parashihte rekrutimin e Kryeinspektorit, e një pozite të Udhëheqësit të Divizionit, si dhe shtatë (7) inspektorëve të rinj. Megjithatë, këto procese nuk kanë arritur të realizohen gjatë periudhës raportuese. Po ashtu, sipas raportit, edhe procesi i ndarjes së divizioneve mbetet ende i parealizuar.

Objektivi konsiderohet i parealizuar edhe pse janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt ngritjes së kapaciteteve institucionale, mungesa e buxhetit të nevojshëm dhe pamundësia për të realizuar rekrutimin e stafit, e kanë penguar zbatimin e plotë dhe efektiv të tij gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Në përmbyllje, performanca e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2025 paraqet një pasqyrë të balancuar. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë ka dëshmuar angazhim në përmbushjen e detyrave thelbësore dhe në forcimin e bazës ligjore dhe profesionale të funksionimit të tij. Megjithatë, mbeten disa sfida që duhen adresuar për të siguruar një sistem inspektues më efektiv, më gjithëpërfshirës dhe më të qëndrueshëm.

Rekomandohet që në vitet në vijim t'i kushtohet vëmendje e shtuar:

- Objektivit - Ngritja e kapaciteteve të Inspektoratit.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional, si dhe mbështetje të duhur buxhetore dhe teknike. Vetëm përmes një angazhimi të koordinuar dhe të qëndrueshëm mund të sigurohet që Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë të vazhdojë të garantojë një sistem të drejtë, funksional dhe të sigurt të ekzekutimit të sanksioneve penale në Republikën e Kosovës.

Donika GËRVALLA SCHWARZ

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë